

Për
Z. Arsim Janova
u.d Kryesues i Bordit të ZRRE-së
Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)
Prishtinë (Kosovë)

Re: Konsultimi publik në lidhje me mbështetjen financiare për 20 MW shtesë të energjisë solare në Kosovë

I nderuar Z. Janova,

Sa i përket konsultimit të mësipërm, Ambasada gjermane do të donte të paraqiste komentet e mëposhtme:

Ambasada mirëpret synimin e Kosovës për të mbështetur 20 MW shtesë të energjisë solare.

Ambasada supozon se Kosova përpiqet të arrijë dy objektiva në politikën e saj të energjisë së ripërtërtshme: a) të përmbushë detyrimet e saj në përmbushjen e objektivave të energjisë së ripërtërtshme sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe b) ta bëjë këtë në një mënyrë që minimizon kostot për qytetarët e Kosovës dhe buxhetin e Kosovës.

Ambasada është e bindur që kjo arrihet më së miri duke i lejuar zhvilluesit e besueshëm të projektit të konkurrojnë për një subvencion qeveritar, për shembull përmes ankandeve. Konkurrenca është një mënyrë transparente për të zbuluar nivelin më të ulët të subvencioneve që Kosova duhet të paguajë për të arritur çdo MW shtesë të energjisë nga burimet e ripërtërtshme. Një konkurrencë e tillë gjithashtu nxit zhvilluesit e projekteve që të zhvillojnë projekte kost efektive, siç është treguar në shumë shembuj ndërkombëtarë, së fundmi në Shqipëri në 2018, por edhe në Gjermani.

Në të kundërtën, një tarifë nxitëse e vendosur nga qeveria ose një agjenci qeveritare nuk arrin të identifikojë subvencionin më të ulët të mundshëm; një tarifë nxitëse mund të jetë shumë e lartë (që i kushton shumë Kosovës për më shumë se një dekadë) ose shumë e ulët (nuk do të aplikojnë zhvillues të besueshëm). Gjithashtu, praktika e kaluar e Kosovës për shpërndarjen e licencave për projekte solare 3 MW mbi bazën “kush vjen i pari, shërbehet i pari” mbart një rrezik korrupsioni dhe presioni të panevojshëm nga zhvilluesit jo të besueshëm mbi qeverinë dhe ZRRE-në.

Ambasada vëren se, në fakt, përkundër licencimit të një numri të projekteve solare 3 MW në Kosovë, vetëm një park solar më i madh prej 6 MW deri tani është ndërtuar sipas skemës aktuale. Kjo vë në pah joefektivitetin e skemës aktuale të tarifave nxitëse në ndërthurje me qasjen “ i pari që kalon pragon zgjidhet”.

Prandaj, Ambasada inkurajon fuqimisht ZRRE-në që të mos vendosë një tarifë nxitëse me vendim administrativ, siç sugjerohet në raportin për konsultim publik, por të përdor një procedurë konkurruese të ofertave për të identifikuar subvencionet minimale të ardhshme të nevojshme për 20 MW shtesë energjisë solare.

Ambasada Gjermane në Prishtinë